



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ prot

Përmet më, _____.____.2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

Drejtuar: Operatorit Ekonomik ZEQILLARI shpk me NIPT L61912024O Adresa: Tiranë Njësia nr 5, Komuna e Parisit Rruga “Osman Myderizi”, Zona Kadastrale 8270, me Nr.pasurie 6/426 – N8.

Procedura e prokurimit/lotit: E Hapur – Punë, prokurim elektronik

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-12374-07-08-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Rikonstruksion i Shkollës 9-Vjeçare “Meleq Gosnishti” Përmet

Kohëzgjatja e kontratës: 6 (gjashtë) muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë 2 (dy) ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. VALONA KONSTRUKSION shpk

Emri i plotë i shoqërisë

K26330202E

Numri i NIPT-t

Vlera 101 566 756,73 (njëqind e një milion e pesëqind gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë presje shtatëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

2. ZEQILLARI shpk

Emri i plotë i shoqërisë

L61912024O

Numri i NIPT-t

Vlera 98 407 650,48 (nëntëdhjetë e tetë milion e katërqind e shtatë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë presje dyzetë e tetë) lekë pa TVSH.

Nga pjesërmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- 1. Operatori Ekonomik VALONA KONSTRUKSION shpk me NIPT K26330202E** me vlerë të ofertës 101 566 756,73 (njëqind e një milion e pesëqind gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë presje shtatëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Konkretisht për arsyet e mëposhtme:

- Ky OE nuk ka ngarkuar në SPE sigurimin e ofertës sipas shtojcës 3.
- Bilanci i vitit 2021 dhe 2022 është pa shkresën konfirmuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
- Puna e ngjashme e paraqitur për përmbushjen e pikës 2.3.1/a me objekt “Ndërtim i objektit hotel në lagjen Uji i Ftohtë Vlorë” ka si porosites Valona Konstruksion shpk dhe si zbatues Valona Konstruksion shpk dhe mban datë lidhje 29.08.2017 pra më shumë se pesë vite nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- Në licensën profesionale të shoqërisë është kërkuar kategoria N.P-3D kurse liçensa me nr. NZ.4064/12 e këtij OE ka kategorinë N.P-3B.
- Në lidhje me përmbushjen e pikës 2.3.3/a Arkitekti i deklaruar Z. Ritvan Marvataj dhe Inxh. Elektronik Z. Shpëtim Bajrami nuk figurojnë si drejtues teknik në liçensën profesionale të shoqërisë. Përsa i përket Inxhinierit Elektronik nuk ka deklaruar që të jetë i pajisur me: Certifikatë CISCO CCNA (Cisco Certified Network Associate) ose ekuivalent (per Nderlidhjen e pajisjeve te rrjetit Kompjuterik dhe Telekomunikacionit), e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Ky OE nuk ka ngarkuar në SPE deklaratën (nga Administratori i shoqërisë) për Drejtuesin Teknik të punimeve dhe deklaratën nga vet drejtuesi teknik për këtë objekt.
- Në lidhje me përmbushjen e pikës 2.3.3/b në formularin e vetëdeklarimit nuk ka deklaruar: Teknik të mesëm elektrik; Teknik të mesëm topograf /gjeodet / gjeometër; Hekurpunues; Termoizolues; Specialist per veshje fasade; Pergatites te konstruksioneve metalike; Marangoz/Mobilier; Murator /suvatues nga (5 persona) të kërkuar janë deklaruar (2 persona); Pllakashtrues nga (5 persona) të kërkuar janë deklaruar (3 persona); Hidroizolues nga (3 persona) të kërkuar janë deklaruar (2 persona); Specialist gipsi nga (3 persona) të kërkuar janë deklaruar (1 person); Specialist per sisteme ngrohje-ftohje nga (3 persona) të kërkuar janë deklaruar (2 persona);
- Ky OE nuk ka plotësuar dhe ngarkuar në SPE tabelën me të dhënat e sakta që i përkojnë diplomës/certifikatës së formimit profesional nga Institucione Private apo Shtetërore.
- Ky OE nuk ka deklaruar 1 (një) punonjës të pajisur me çertifikatë për “Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” lëshuar nga Ministria e Mjedisit.
- Ky OE nuk ka deklaruar 1 (një) punonjës të pajisur me çertifikatë si “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Ky OE nuk ka deklaruar 2 (dy) “Pergatites te konstruksioneve metalike”; 3 (tre) “Specialiste Veshje Fasade” dhe 2 (dy) “Karpentiere” që të disponojnë çertifikatë trajnimi “Për punime në lartësi”, sipas V.K.M nr.312 date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.
- Ky OE nuk ka deklaruar 1 (një) punonjës të trajnuar dhe të kualifikuar për përdorimin dhe instalimin e kaldajave me avull dhe uje te nxehte sipas "Rregullores se sigurimit

teknik te kaldajave te avullit dhe ujit te nxehte" dhe ligjit Nr. 32/2016 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion".

- Ky OE nuk ka deklaruar 1 (një) punonjës të trajnuar dhe të kualifikuar për përdorimin dhe instalimin e rezervuareve të gazit (GLN ose LPG) mbi toke dhe nentoke sipas vendimit Nr. 1062, datë 23.12.2015 "Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet dhe bashkësitë nën presion" dhe ligjit Nr. 32/2016 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion".
- Për përmbushjen e pikës 2.3.5 ky OE nuk ka deklaruar: Autovinc me kapacitet ngritës mbi 5 ton; Vidiator; Trapan; Nivelues me lazer; Aparat lidhje per fiber optike; Freze per rrafshim/hapje kanalesh ne mur; Pompë presioni për testimin e tubave nën presion; Pajisje/Makineri për bashkimin e tubave PPR; Pajisje/Makineri për bashkimin e tubave PEX; Nga (3 copë) Matrapik të kërkuar është deklaruar vetëm (1 copë)
- Ky OE nuk ka paraqitur në SPE asnjë dokument për përmbushjen e pikave 2.3.7; 2.3.8; 2.3.9 dhe 2.3.10 të kërkuara në DST.

Sqarojmë se, bazuar në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i RSH", barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë.

Një nga parimet kryesore ku mbështetet veprimtaria e zyrtarëve publikë, sic janë zyrtarët e prokurimit është parimi i ligjshmërisë i sanksionuar në Kodin e Procedurës Administrative si dhe në Ligjin e prokurimeve. Ky parim, do të thotë që zbatimi i një norme të caktuar apo një kriteri për kualifikim në rastin konkret duhet të bëhet në harmoni me bazën tjetër ligjore të aplikueshme në fuqi.

Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, *vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.*

Nga shqyrtimi i këtyre ofertave në SPE si dhe referuar kriterëve të pranimit dhe kualifikimit komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se operatori ekonomik i mësipërm ***nuk ka paraqitur dokumentacion*** të plotë në përputhje me kriteret e vendosura duke e ***SKUALIFIKUAR si ofertë.***

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik ZEQILLARI shpk me NIPT L619120240 me adresë Tiranë Njësia nr 5, Komuna e Parisit, Rruga "Osman Myderizi", Zona Kadastrale 8270, me Nr pasurie 6/426 –N8 se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 98 407 650,48 (nëntëdhjetë e tetë milion e katërqind e shtatë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë presje dyzetë e tetë) lekë pa TVSH është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Alma HOXHA